

**AKT THEMELIMI**  
**“VOLTON” SHPK**

**1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë**

Emri i shoqërisë do të jetë **“VOLTON” SHPK**, e quajtur më poshtë me emrin “shoqëria”, e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar” ose “SHPK”.

**2. Ortakët e shoqërisë**

Ortakët e shoqërisë janë:

- **“Albanian Development Copmpany ADC” SH.P.K**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Rruga “Rezervat e Shtetit” Lundër 1, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: **L52104227K**, e përfaqësuar nga administratori Zt. **Eneid Lika**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 21.05.1980, identifikuar me Kartë Identiteti me Nr. **033982380** dhe nr. Personal **I00521201V**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

**3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- *Veprimtari në sigurimin, transmetimin, shpërndarjen, importimin, eksportimin dhe tregtimin me shumicë ose pakicë brenda dhe jashtë vendit të energjisë elektrike. Prodhim, Import-Eksport, tregtim, furnizim i energjisë elektrike, energjisë diellore dhe energjisë nëpërmjet erës. Në mënyrë përmbushje objektin e mësipërm, Shoqëria ka të drejtë të lidh çdo lloj kontrate dhe/ose marrëveshje me persona fizikë ose me ente private, publike, shoqëri dhe organizata të huaja dhe/ose Shqiptare.*
- *Si edhe çdo veprimtari tjetër tregtare, e lejueshme nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.*



Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

#### 4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rruga “Rezervat e Shtetit”, Lundër 1, Farkë, Zona Kadastrale Nr. 2529, Numri i Pasurisë 590/1/14, Volumi 6, Faqe 106, Tiranë.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

#### 5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

#### 6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **ALL 100 Lekë (njëqind lekë)**.
- Kapitali përbëhet nga **një kuotë** të cilat zotërohen nga:
  - **Albanian Development Company ADC Sh.P.K**, zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

#### 7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve (kompetencat e së cilës ushtrohen nga Ortaku i Vetëm).
- Administratori.



## 8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administratori i parë i shoqërisë do të jetë:
  - **Mirjan Petro**, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan, më datë 02.05.1990, identifikuar me Kartë Identiteti me Nr. 034768357 dhe nr. Personal J005020700, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

## 9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

### ORTAKU I VETËM

**Albanian Development Company ADC SH.P.K**  
**Përfaqësuar nga administratori**

**Eneid Lika**

